

LIGJ
Nr. 74/2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 108/2013
“PËR TË HUAJT”¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt” bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 dhe kudo ku është përdorur në ligj, termi “largim me forcë” zëvendësohet me fjalën “largim”;

2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. “Punëtor stinor” është i huaji, i cili e ka vendbanimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por, përkohësisht, qëndron ligjërisht në territorin e saj, për të kryer një aktivitet të punës stinore, në bazë të një ose më shumë kontratave të punës, me kohë të përcaktuar, të lidhura ndërmjet të huajt dhe punëdhënësit, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

3. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. “Personeli kyç” janë të huajt, sipas katego-rive të mëposhtme:

a) “vizitorë biznesi” janë personat fizikë, të cilët punojnë në një pozicion drejtues brenda një personi juridik dhe janë përgjegjës për ngritjen e një aktiviteti tregtar. Ata nuk angazhohen në transaksione të drejtpërdrejta me publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që ndodhet brenda palës pritëse;

b) “të transferuar brenda ndërmarrjes/shoqë-risë” janë personat fizikë, të cilët kanë qenë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose kanë qenë ortakë të tij për gjashtë muaj të pandërprerë, që paraprijnë menjëherë këtë transferim dhe janë transferuar përkohësisht në një degë të ndërmarrjes/shoqërisë (duke përfshirë departamentet ose sektorët) në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas këtyre nënkategorive:

i) “menaxher” nënkupton një person, i cili mban një pozicion të lartë dhe drejton menaxhimin e subjektit pritës, merr mbikëqyrje të përgjithshme ose udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose i aksionarëve të biznesit. Ky pozicion përfshin: drejtimin e subjektit pritës, të një departamenti ose nënndarjeje të tij; mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë, specialistëve apo menaxherëve; autoritetin për të rekomanduar punë-simin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje

¹ Ky ligj është i përafshirë pjesërisht me:

Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda ndërmarrjes”, numri CELEX 32014L0066, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 27.5.2014, faqe 1–22.

Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime punësimi si punonjës sezonal”, Numri CELEX 32014L0036, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 375–390.

Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”, Numri CELEX 32009L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 155, datë 18.6.2009, faqe 17–29.

Direktivën 96/71/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetori 1996, “Në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve”, Numri CELEX 31996L0071, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 18, datë 21.1.1997, faqe 1–6.

me personelin;

ii) “specialist” nënkupton një person, i cili punon për grupin e ndërmarrjeve/shoqërive, zotëron njohuri të specializuara, thelbësore për fushat e aktivitetit të njësisë pritëse, teknikave apo menaxhimit. Në vlerësimin e njohurive të tilla duhet të merren parasysh jo vetëm njohuritë specifike për njësinë pritëse, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë të kualifikimit, duke përfshirë përvojën e duhur profesionale, referuar një lloji pune ose aktiviteti që kërkon njohuri të veçanta teknike, duke përfshirë edhe mundësinë e pasjes së një profesioni të njohur;

iii) “praktikantët e diplomuar” janë personat fizikë, të cilët kanë qenë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për të paktën 3 muaj të pandërprerë, që paraprijnë menjëherë këtë transferim, zotërojnë një diplomë universitare dhe janë transferuar përkohësisht në një degë të tij në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime të zhvillimit të karrierës apo për t’u trajnuar në metodat/teknikat e biznesit dhe të cilët paguhën gjatë periudhës së transferimit.”.

4. Pas pikës 32 shtohen pikat 33, 34, 35, 36, 37 e 38 me këtë përmbajtje:

“33. “Ofrues shërbimesh biznesi” janë personat fizikë, përfaqësues të një ofruesi shërbimesh jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët kërkojnë hyrje të përkohshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim negocimin e shitjes së shërbimeve ose lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve, për llogari të ofruesit të shërbimeve. Ata nuk angazhohen në shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërbtim nga një burim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

34. “Ofrues shërbimesh kontraktuale” janë personat fizikë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka një kontratë për të ofruar shërbime me një konsumator në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kërkon praninë e punonjësve të tij, në një degë të përkohshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të përmbushë kontratën e ofrimit të shërbimeve.

35. “Profesionistë të pavarur” janë personat fizikë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi, të cilët janë të regjistruar si të vetëpunësuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kanë një kontratë, për ofrimin e shërbimeve, me një përfitues në Republikën e Shqipërisë.

36. “Person me statusin e mbrojtjes plotësuese” ka kuptimin sipas përkufizimit të bërë në ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

37. “Mbrojtja e përkohshme” i jepet të huajit, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

38. “Ministri” është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 2, fjalët “struktura që mbulon çështjet e shtetësisë dhe refugjatët” zëvendësohen me fjalët “autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në pikën 5, pas fjalëve “zyrat konsullore jashtë vendit” shtohen fjalët “zyrat konsullore të nderit të Republikës së Shqipërisë, si dhe agentë të tjerë të kontraktuar në shtete të huaja”.

Neni 3

Në nenin 10, pika 1, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Fjalët “në nenin 8, të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “në nenin 6, të këtij ligji”.

2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) përdor në hyrje një dokument të një personi tjetër ose dokument/vizë të falsifikuar apo një dokument të paautorizuar për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 4

Në nenin 15, pika 2, pas fjalëve “që ka lëshuar atë”, shtohen fjalët “ose shtetas të huaj me leje qëndrimi në atë shtet”.

Neni 5

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) i revokohet statusi i refugjatit dhe/ose është subjekt i largimit/dëbimit nga territori i Republikës së Shqipërisë.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Lëshimi i lejes së kalimit për të huajt, të cilët do të kthehen në vendin ku pranohen, në vendin e rezidencës apo të origjinës, bëhet nga autoritetet rajonale për kufirin dhe migracionin në juridiksionin territorial ku i huaji ka pasur së fundmi vendqëndrimin e tij dhe nga autoritetet konsullore të Republikës së Shqipërisë, kur i huaji ndodhet jashtë shtetit.”.

Neni 6

Në nenin 22, pika 3, pas fjalëve “mbajtësit e vizave të tipit “D/H”, lëshuar për motive humanitare”, shtohen fjalët “dhe të tipit “D/DS”, lëshuar për motiv shërbimi”.

Neni 7

Në nenin 24, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Në rast se nuk ka përfaqësi diplomatike/ konsullore shqiptare në shtetin e aplikuesit ose në vendin ku ai është banor, i huaji bën kërkesë me postë në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin e parashikuar, sipas një liste të miratuar me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme, e cila publikohet në përputhje me legjisla-cionin në fuqi. Paraqitja personalisht për marrjen e vizës nga i huaji bëhet sipas pikës 4 të këtij neni.”.

Neni 8

Në nenin 25, pika 2, fjalët “të nenit 21” zëvendësohen me fjalët “të nenit 23”.

Neni 9

Në nenin 27, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin zgjat afatin e qëndrimit të përcaktuar në vizën e lëshuar apo afatin e lejuar të qëndrimit pa vizë, nëse i huaji kërkon zgjatjen e qëndrimit para përfundimit të afatit të vlefshëm të qëndrimit, vetëm për motive që vlerësohen të një rëndësie të veçantë, të një force madhore ose humanitare, kur nuk ka pasur mundësi të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë para përfundimit të afatit të lejuar.”.

Neni 10

Në nenin 30, pika 2, pas fjalëve “90 ditë brenda 180 ditëve nga hyrja”, hiqet fjala “e parë”.

Neni 11

Në nenin 33, pika 1, shkronja “a”, hiqen fjalët “jo e ripërtëritshme”.

Neni 12

Në nenin 35 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, shkronja “c”, pas fjalës “i huaji” hiqet fjala “është” dhe shtohen fjalët “përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike dhe”.

2. Në pikën 2, pas fjalëve “mund të”, shtohen fjalët “lëshohet ose”.

Neni 13

Në nenin 36, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Kundër urdhrit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes apo të anulimit të lejes së qëndrimit, i huaji ka të drejtën e ankimit administrativ tek autoriteti epror i drejtpërdrejtë i

autoritetit që ka nxjerrë urdhrin, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Procedura e shqyrtimit të ankimit adminis-trativ duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit administrativ. Kundër vendimit të organit epror bëhet ankim në gjykatën kompetente për çështjet adminis-trative, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 14

Në nenin 38, pika 1, fjalët “jo më vonë se” zëvendësohen me fjalën “brenda”.

Neni 15

Në nenin 40, pika 5, shkronja “a”, fjala “së paku” zëvendësohet me fjalët “deri në”.

Neni 16

Në nenin 42, pika 5, shkronja “a”, fjala “së paku” zëvendësohet me fjalët “deri në”.

Neni 17

Në nenin 53, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Leja e qëndrimit, e lëshuar për këtë motiv, shërben vetëm për qëndrimin e të huajit dhe nuk mundëson rihyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rast se i huaji del nga territori. Leja e qëndrimit për këtë motiv lëshohet me afat 1-vjeçar dhe rinovohet vetëm në rastet, kur:

a) vlerësohet se qëndrimi i saj/i tij nuk përbën kërcenim për sigurinë publike dhe atë kombëtare;

b) vlerësohet se ekziston një vullnet i qartë i personit për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal;

c) është në pritje të vlerësimit të statusit nga autoritetet kompetente.”.

Neni 18

Në nenin 65, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pajiset me leje të përhershme qëndrimi i huaji, familjarët e tij dhe personeli i tij kyç, i cili ka kryer një investim në Republikën e Shqipërisë, në sektorë strategjikë, në vlerën jo më pak se 2 milionë euro dhe dokumenton se ka krijuar mbi 100 vende pune, minimalisht për një periudhë 1-vjeçare.”.

Neni 19

Në nenin 70, pika 1, hiqen fjalët “si dhe banori i përkohshëm”.

Neni 20

Në nenin 73 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) ofrues shërbimesh biznesi, të cilët nuk angazhohen në shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që gjendet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”.

2. Në pikën 3, shkronja “c”, ndryshohet si më poshtë:

“c) përfaqësuesit dhe stafi i organizatave jofitim-prurëse, të njohura dhe të regjistruara në organet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk shpërblehen për punën e tyre”.

3. Në pikën 3, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) përfaqësuesit dhe stafi i bashkësive fetare, të njohura dhe të regjistruara në organet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, të cilët kryejnë aktivitete të lidhura ekskluzivisht me shërbimin fetar apo bamirës dhe nuk shpërblehen për punën e tyre”.

Neni 21

Në nenin 80, pika 1, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) kur i huaji ndërpret kontratën e punës, për arsye të ndryshme, dhe largohet nga vendi i punës për të cilin ka marrë lejen.

Në këtë rast, punëdhënësi informon, brenda 2 javëve, autoritetet përgjegjëse ku i huaji është pajisur me lejen e punës dhe atë të qëndrimit.”.

Neni 22

Në nenin 84 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas fjalës “paraardhës” shtohen fjalët “kur subjekti ka aktivitet në vazhdimësi dhe 10 për qind të totalit të të punësuarve në momentin e aplikimit, për subjektet e hapura rishtas”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Autoriteti shtetëror përgjegjës për punësim, përpara miratimit të kërkesës së të huajit për plotësimin e një vendi të lirë pune, propozon, brenda afatit kohor të publikimit të vendit të lirë të punës, kandidatë të përshtatshëm, sipas profilit të kërkuar, të gatshëm të punojnë në vendin vakant të punës, si më poshtë:”.

Neni 23

Në nenin 87, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet kur i huaji nuk i plotëson krite-ret e përcaktuara në nenin 103, të këtij ligji, për t’u pajisur me leje pune të përhershme dhe nëse nuk kanë ndryshuar kushtet e punës, për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës, i huaji pajiset me leje pune të tipit “A/P”, me afat njëvjeçar, e ripërtëritshme dy herë radhazi me afat dyvjeçar.”.

Neni 24

Në nenin 88 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 hiqen fjalët “dhe që të rikthehet në vendin e origjinës pas përfundimit të kontra-tës së punës”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rast se kontrata/oferta e punës e të huajit përcakton se aktiviteti që do të ushtrojë është një profesion i rregulluar, i huaji duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në përputhje me të drejtën kombëtare të ushtrimit të profesioneve të rregulluara.”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Pas përfundimit të kontratës së punës, i huaji duhet të rikthehet në vendin e tij të origjinës, me përjashtim të rasteve kur plotëson kriteret, sipas legjislacionit në fuqi, për t’u pajisur me leje qëndrimi.”.

Neni 25

Në nenin 89 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të huajt, të cilët transferohen nga një ndërmarrje/shoqëri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një degë të saj (duke përfshirë departamentet ose sektorët) në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të kenë qenë të punësuar për këtë ndërmarrje/shoqëri, për një periudhë:

a) gjashtëmujore të pandërprerë, që paraprin menjëherë këtë transferim, për kategoritë:

i) administrator;

ii) specialistë.

b) tremujore të pandërprerë, që paraprin menjëherë këtë transferim, për kategorinë “praktikantë të diplomuar.”.

2. Në pikën 2, shkronja “c”, fjala “kompani” zëvendësohet me fjalët “ndërmarrje/shoqëri” dhe shkronja “ç” shfuqizohet.

3. Pika 3 shfuqizohet.

4. Në pikën 7, fjalët “personel kryesor” zëvendësohen me fjalën “administratorë”.

5. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Periudha fillestare e vlefshmërisë së lejes së punës për të transferuarit brenda ndërmarrjes/ shoqërisë, të cilët bëjnë pjesë në kategoritë administratorë apo specialistë, është e barabartë me kohëzgjatjen e kërkuar për kryerjen e punës së përcaktuar, duke filluar nga koha e transferimit të tij deri në një periudhë maksimale të vlefshmërisë prej pesë vjetësh.”.

Neni 26

Në nenin 90, pika 1, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) në rastin e “Praktikantëve të diplomuar”, punëdhënësi paraqet një marrëveshje trajnimi, e cila përmban programin e trajnimit, kohëzgjatjen e tij, si dhe kushtet në të cilat praktikanti do të mbikëqyret.”.

Neni 27

Në nenin 98 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, fjalët “së paku 2-vjeçare” zëvendësohen me fjalët “minimale 1 vit”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Leja e punës e tipit “A/KL”, nëse plotësohen kriteret e kërkuara, jepet për herë të parë me një afat jo më pak se 1 vit, ripërtërihet më pas dy herë të tjera me një afat 2-vjeçar dhe më pas me afat të përhershëm.”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet kur i huaji nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 103, të këtij ligji, për t’u pajisur me leje pune të përhershme dhe nëse nuk kanë ndryshuar kushtet e punës, për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës, i huaji pajiset me leje pune të tipit “A/KL”, me afat 1-vjeçar, e ripërtëritshme dy herë radhazi me afat 2-vjeçar.”.

Neni 28

Në nenin 100 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjala “trevjeçar” zëvendësohet me fjalën “dyvjeçar”.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1. Leja e punës për investitorin e huaj është e ripërtëritshme me afat kohor trevjeçar, nëse nuk kanë ndryshuar kushtet për të cilat është dhënë leja e mëparshme, fillestare, e punës.

1/2. Leja e punës është e përhershme, pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së lejes së dytë me afat trevjeçar, nëse nuk kanë ndryshuar kushtet për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës.

1/3. Në rastet kur investitori i huaj nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 103, të këtij ligji, për t’u pajisur me leje pune të përhershme dhe nëse nuk kanë ndryshuar kushtet e punës për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës, i huaji pajiset me leje pune të tipit “B/I”, me afat dyvjeçar, e ripërtëritshme me afat trevjeçar.”.

Neni 29

Në nenin 101 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “b”, nënparagrafët “iv” dhe “v”, ndryshohen si më poshtë:

“iv) punonjës në bazë kontratash, të cilët shpërblehen për punën e tyre në një organizatë të huaj, të regjistruar si një organizatë jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë;

v) përfaqësues dhe anëtarë të bordit drejtues të organizatave jofitimprurëse, të njohura dhe të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilët punojnë në bazë kontratash dhe shpërblehen për punën e tyre.”.

2. Në shkronjën “b”, pas nënparagrafit “vii” shtohet nënparagrafi “viii” me këtë përmbajtje:

“viii) vizitorë biznesi me qëndrim të përkohshëm.”.

3. Shkronjat “c” dhe “ç” ndryshohen si më poshtë:

“c) ofruesit të shërbimeve të biznesit, të cilët nuk angazhohen në shitje të drejtpërdrejta për publi-kun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që gjendet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) refugjati, i huaji në mbrojtje të përkohshme dhe personi me statusin e mbrojtjes plotësuese, në përputhje me ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 30

Në nenin 102, pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ofruesit e shërbimeve kontraktuese, të cilëve u lejohet hyrja për ofrimin e shërbimeve, do t’u nënshtrohen këtyre kushteve:

a) duhet të jenë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në një bazë të përkohshme në Repu-blikën e Shqipërisë. Gjatë periudhës së shkëputjes duhet të ekzistojë një marrëdhënie pune ndër-mjet punonjësit dhe personit juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka një kontratë shërbimi me subjektin e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;

b) duhet të kenë të paktën dy vjet eksperiencë në fushën e veçantë, objekt i kontratës së shërbimit;

c) personat fizikë, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për të ushtruar një veprimtari në bazë të ligjit, rregulloreve ose kërkesave të palës ku shërbimi ofrohet, duhet të kenë kualifikimet profesionale përkatëse, kur kjo gjë është e nevojshme;

ç) personat fizikë nuk do të marrin shpërblim për ofrimin e shërbimeve të tjera, përveç shpër-blimit të dhënë nga klienti, me të cilin punëdhënësi i tij/i saj ka një kontratë për ofrimin e shërbimit;

d) hyrja e përkohshme dhe qëndrimi i tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë do të jetë për një periudhë të përgjithshme jo më shumë se dymbëdhjetë muaj ose në përputhje me kohëzgjatjen e kontratës, gjithmonë kur qëndrimi nuk e kalon periudhën dymbëdhjetëmujore;

dh) numri i personave të mbuluar nga kontrata e shërbimit nuk mund të jetë më i madh sesa është e nevojshme për të përmbushur kontratën. Ky numër mund të përcaktohet nga ligjet, rregulloret dhe kërkesat e palës ku shërbimi do të ofrohet.

2/2. “Profesionistët e pavarur”, të cilëve u lejohet hyrja për ofrimin e shërbimeve, do t’u nënshtrohen këtyre kushteve:

a) duhet të jenë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në një bazë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, kur ata janë të regjis-truar si persona të vetëpunësuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, duhet të kenë një kontratë shërbimi për një periudhë që nuk i kalon dymbëdhjetë muaj;

b) personat fizikë, që hyjnë për ofrimin e shërbimit, duhet të zotërojnë, së paku, tre vjet përvojë profesionale në fushën e aktivitetit që është objekt i kontratës;

c) personat fizikë, që hyjnë në Republikën e Shqipërisë për ofrimin e një shërbimi kontrak-tual, duhet të kenë kualifikime profesionale, kur kjo është e nevojshme, për të ushtruar një veprimtari në bazë të ligjit, rregulloreve ose kërkesave të palës që e merr këtë shërbim.

2/3. Hyrja e përkohshme dhe qëndrimi i profesionistëve të pavarur në shërbim të palës së interesuar do të jetë për një periudhë të përgjith-shme jo më shumë se dymbëdhjetë muaj ose për kohëzgjatjen e kontratës, cilado qoftë ajo, por, gjithmonë, kur qëndrimi nuk e kalon periudhën dymbëdhjetëmujore.”.

Neni 31

Në nenin 105, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Përfshihen nga tarifa shtetërore për pajisjen me leje qëndrimi shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e përkatësive etnike shqip-tare të republikave të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, që qëndrojnë në Republikën e Shqipë-risë për qëllime studimi.”.

Neni 32

Në nenin 119 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. I huaji ka të drejtë të ankimojë urdhrin e qëndrimit në një territor të caktuar në gjykatën kompetente për çështjet administrative.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Fondet për qëndrimin në një territor të caktuar mbulohen nga buxheti i ministrisë së Punëve të Brendshme. Mënyra e administrimit të fondeve dhe qëndrimit në një territor të caktuar përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 33

Në nenin 141 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Profili vjetor i migracionit miratohet me urdhër të ministrit, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit pasardhës.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Profili i zgjeruar i migracionit përgatitet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave statistikore për migracionin një herë në katër vjet, brenda 9-mujorit të vitit pasardhës, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 34

Në nenin 145, pika 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) Dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 30 000 lekë i huaji, i cili:

i) gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë pa dokumentin e kërkuar të udhëtimit, vizën apo lejen e qëndrimit apo nuk përmbush detyrimin për t’u regjistruar apo për të aplikuar për leje qëndrimi;

ii) punësohet me pagesë ose praktikon një zana, pa të drejtë për punësim fitimprurës;

iii) nuk përmbush, nëse i kërkohet, detyrimin për të raportuar ose kërkesën për t’u paraqitur para autoriteteve për të dhënë informacion.”.

Neni 35

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 2, të nenit 32, dhe të pikës 2, të nenit 33, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri i Punëve të Jashtme që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.7.2016

Shpallur me dekreten nr. 9709, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani